

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin Ca'Foscari të Venecias në Itali për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Ca' Foscari të Venecias në Itali, në kuadër të programit Erasmus +, për stafin me kohë të plotë të marrëdhënies me jashtë në Rektoratin e Universitetit të Tiranës për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit të marrëdhënies me jashtë për trajnim.

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit (5 + 2 ditë).

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (160 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë të marrëdhënies me jashtë:

- CV (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Formulari i aplikimit, sipas linkut:
http://www.unitir.edu.al/images/Application_Form_Ca_Foscari.docx
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);

- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/italiane);
- Letër suporti nga Universiteti i Ca'Foscari (mund të kontaktoni tek: international.cooperation@unive.it duke dërguar CV);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo një bursë shkëmbimi Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Training_outgoing.docx

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat.

Afati për aplikim: 19 Korrik 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!